

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Mjeti Elektronik i emëruar për dy vite”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- 48211000-0 - Paketa software për platforma ndërlihdhëse

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

2,000,000.00 (dy milion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:** u arsyetua që OE duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe Sigurimin e Ofertës, në ditën e hapjes së ofertës sipas Shtojcës 9 dhe Shtojcës 3 përkatësisht.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe nenin 82 të LPP, nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2 Në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1 Në përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro minimale vjetore, në një vlerë të paktën prej 800,000.00 (tetëqind mijë) Lekë pa TVSH, gjatë tre viteve të fundit financiare, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse OE ofertues arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si provë për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaratës të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimet objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të provojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me termat e referencës të kërkuara. OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe për këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros duhet të jetë në vlerën 800,000.00 (tetëqind mijë) Lekë pa TVSH gjatë tre viteve të fundit financiare. Vendosija e këtij kriteri është bërë me qëllim që ti shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

---

**2.3 Përsa i përket aftësive teknike dhe profesionale** të operatorëve ekonomik, u arsyetua që ofertuesi duhet të tregojë se i zotëron këto aftësi dhe është në gjendje ta kryejë kontratën objekt prokurimi. Në lidhje me këtë u arsyetua dhe argumentua se Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

*2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 400,000.00 (katërqind mijë) lekë.*

- *Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave/sherbimeve të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55 pika 4, paragrafi i dytë i VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimet objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë limiti maksimal në mënyrë që AK të ketë sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK, si dhe do të kompromentonin sigurinë e sistemeve funksionale për veprimtarinë ligjore të AK.

2.3.2 *Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar vjetor i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 3 (tre) punonjës, ku të përfshihet personel me certifikime si vijon:*

- 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projekti
- 1 (një) punonjës të certifikuar për administrator databaze për administrimin e bazës së të dhënave.
- 1 (një) punonjës të certifikuar për sisteme infrastrukturë cloud

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikatë.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar, shoqëruar me listëpagesat përkatëse E-Sig.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

- Për stafin që nuk disponohet në listëpagesa, të dorëzohet kontrata e bashkëpunimit ose çdo formë ligjore e marrëveshjes me personin që përmbush certifikimin e kërkuar, e vlefshme, për periudhën e ekzekutimit të kontratës.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Shënim: Në plotësimin e “Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit”, në piken B “Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, OE ofertues duhet të shënojë në mënyrë të saktë, kualifikimet përkatëse të punonjësve. Këto deklaramë do të shqyrtohen

*kur OE ofertues do të paraqesë dokumentet origjinale ose kopje të noterizuara për punonjësit, pas shpalljes fituese të ofertës. Keqinformimi dhe deklarimi i rremë me qëllim kualifikimin e ofertës, në mënyrë të padrejtë, sanksionohet nga pika 1/a, të nenit 78 “Përjashtimi për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik”, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.*

**Argumentimi:** Kërkesa për stafin e nevojshëm për kryerjen e shërbimit objekt procedure prokurimi bazohet në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4/c, të nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ky numër punonjësish konsiderohet optimal për shërbimin e kërkuar objekt kontrate.

- 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projekti

Për mire menaxhimin e kontratës dhe sigurinë që të përmbushen detyrimet kontraktuale, është e domosdoshme prezenca e një menaxheri projektesh të certifikuar.

- 1 (një) punonjës të certifikuar për sisteme infrastrukturë cloud

Ky projekt kërkon që shërbimet e marra të jenë në Cloud dhe për këtë është e nevojshme që të një pjesëe e stafit të ketë specializimin në cloud. Këto njohuri janë specifike dhe të domosdoshme për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve.

- 1 (një) punonjës të certifikuar për administrator databaze për administrimin e bazës së të dhënave

Ky projekt kërkon që të dhënat të jenë të ruajtura në bazë të dhënash. Për këtë është e nevojshme që të jetë pjesë e stafit të paktën një person që ka aftësi në “database”.

*2.3.3 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikatën përkatëse të vlefshme ISO, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:*

- *ISO 9001: për sistemin e menaxhimit të cilësisë*
- *ISO 27001: për menaxhimin e sigurisë së informacionit*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimet e nenit 77 dhe 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në bazë Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohet se këto Çertifikata duhet të jenë të lëshuara nga

organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anën e këtij kriteri (standartit ISO 9001; ISO 27001) synohet që të njihet aftësia e operatorit për të ofruar punë që plotësojnë kërkesat e Autoritetit Kontraktor, si dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore sipas standardeve më të larta.

- **Standardi i cilësisë ISO 9001:** është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektorëve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.
- **Standardi i cilësisë ISO 27001:** siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria. Për shkak të rëndësisë së veçantë që ka AK, posaçërisht në sistemin elektro-energjitik, gjykohet se informacioni duhet mbrojtur, si dhe duke qënë se kërkohet rinovimi i licensave të pajisjeve multifunksionale që aktualisht janë në përdorim. Çertifikimi sipas kësaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep sigurinë e nevojshme AK.

#### *2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për mallrat/shërbimet objekt prokurimi.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pikën 6, të nenit 41 dhe nenin 44, pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Suporti i prodhuesit/distributorit të autorizuar, është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e suportuesve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë krijuar me standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushje me sukses të kontratës.

#### *2.3.5 Në funksion të plotësimit të Shtojces 9 “Formulari përmbledhes i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.*

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1 dhe nenit 82 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor ALPEX sh.a ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atësi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shënim:**

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- ii. Në plotësimin e “Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit”, në pikën “Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, OE ofertues duhet të shënojë në mënyrë të saktë, si provë paraprake: degën e studimeve të punonjësit, si dhe profilin përkatës të diplomës (nesë ka), si dhe emërtimet e certifikimeve/trajnimeve përkatëse, si dhe mjetet dhe makineritë që disponon për plotësimin e kriteve të veçanta të kualifikimit. Këto deklarime do të shqyrtohen kur OE ofertues të paraqesë dokumentet origjinale ose kopje të noterizuara për punonjësit, pas shpalljes fitues të ofertës. Keqinformimi ose deklarimi i rremë me qëllim kualifikimin e ofertës, në mënyrë të padrejtë, sanksionohet nga pika 1/a e nenit 78 “Përrjashtimi për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik” të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

**Argumentimi i termave të referencës**

*Specifikimet teknike dhe Termat e Referencës, janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat dhe shërbimet objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasishtë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.*